



United Nations
Human Rights

OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER FOR HUMAN RIGHTS

Memorandumi i Mirëkuptimit i modelit aktual (Memorandum i Mirëkuptimit) është konceptuar nga OHCHR si një mekanizëm për formalizimin e marrëdhënieve bashkëpunuese të punës midis Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI-ve) dhe Zyrave Kombëtare të Statistikave (NSO-ve). Ky Memorandum Mirëkuptimi kërkon të ndihmojë palët në shkëmbimin e njohurive, ekspertizës si dhe në bashkëpunimin e tyre për mbledhjen zyrtare të të dhënave, shpërndarjen dhe analizën e tyre.

Veçanërisht, disa nga mënyrat që NHRI-të mund të kontribuojnë në procesin e statistikave zyrtare janë si për shembull:

- Sigurimi i informacionit për grupet vunerabël, të pafavorizuara ose grupeve në rrezik të lëna pas në axhendën e vitit 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, përfshirë mbështetjen për mënyrën e nxitjes dhe përkrahjes së të drejtave të njeriut në mbledhjen e të dhënave për këto grupe;
- Këshillim për publikimin dhe shpërndarjen e të dhënave që rezultojnë në "kthimin e informacionit" (d.m.th., kthimin e të dhënave përfundimtare te grupet që i kanë siguruar ato në një mënyrë që ata të mund të përdorin); dhe
Ndihmë për interpretimin dhe analizimin e të dhënave për grupet kryesore të interesit.

Njëkohësisht, NSO-të kanë shumë ekspertizë për të ofruar, çka është e rëndësishme për punën e NHRI-ve, siç janë:

- Puna kërkimore, analiza e të dhënave dhe menaxhimi i tyre
- Disponueshmëria e të dhënave zyrtare (ose i të dhënave nga burime të tjera) për çështje me interes për NHRI-të

Këto marrëdhënie mund të jenë të vlefshme në kontekstin e punës së shteteve gjatë zbatimit dhe matjes së progresit brenda Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe në përkthimin e Deklaratës Merida të miratuar nga NHRIs në nivel vendi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Nr. 1307 Prot., datë 03.09.2020

Nr. 312 Prot., datë 03.09.2020

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

**PËR BASHKËPUNIM NË FUQIZIMIN E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE,
(NDARJEN), PËRHAPJEN DHE ANALIZËN NË DRITËN E TË DREJTAVE TË
NJERIUT DHE AGJENDËS TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM 2030**

Ndërmjet:

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

në vijim referuar si “INSTAT” dhe

AVOKATIT TË POPULLIT

në vijim referuar si “AP”

Avokati i Popullit dhe Instituti i Statistikave,

- Duke marrë në konsideratë miratimin e “Duke transformuar botën tonë: Agjenda e 2030 për Zhvillim e Qëndrueshëm” (A/RES/70/1) e cila siguron një Agjendë të bazuar në mënyrë të qartë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Traktatet ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe instrumente të tjera siç është Deklarata mbi të Drejtën për Zhvillim;
- Duke rikujtuar angazhimet e Agjendës 2030 për një Zhvillim të Qëndrueshëm për t’u zbatuar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e shteteve në kuadër të ligjit ndërkombëtar dhe për të zhvilluar ndarjen e të dhënave në mënyrë cilësore, të arritshme, në kohë dhe të besueshme, për të ndihmuar me matjen e progresit dhe për të siguruar që “asnjë të mos mbetet prapa”;
- Duke marrë në konsideratë traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe rëndësinë e informacionit statistikor, në veçanti indikatorët e ndarë, në matjen e realizimit të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e rekomandimeve nga mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut;



- Duke marrë në konsideratë “Parimet e Parisit” të lidhura me statusin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (A/RES/48/134) dhe Deklaratën e Konferencës së Dymbëdhjetë Ndërkombëtare për Komitetin e Koordinimit Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (“Deklarata Merida”), e cila vendos parimet për angazhimin e institucioneve të të drejtave të njeriut me aktorë të tjerë me qëllim mbështetjen e zbatimit të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030;
- Duke marrë në konsideratë Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare (A/RES/68/261), Deklaratën mbi Etikën Profesionale e miratuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Institutit të Statistikave, kuadrin e treguesve të zhvilluar nën kujdesin e Komisionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara për të matur Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, dhe planin e veprimit global të Cape Town-it, për të dhënat e zhvillimit të qëndrueshëm e përgatitur nga Grupi i Nivelit të Lartë për Partnership, Koordinim dhe Ndërtim-Kapacitetesh për Statistikat për Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, e cila identifikon prioritetet kyçe për zyrtarët e statistikave në mbështetje të matjes së progresit dhe rezultateve;
- Duke marrë në konsideratë publikimet dhe udhëheqjen mbi “Indikatorët e të Drejtave të Njeriut: një Udhëzues mbi Matjen dhe Zbatimin e tyre” dhe “Një Përjasje e statistikave bazuar tek të drejtat e njeriut: Asnjë të mos mbetet prapa në Agjendën e Zhvillimit 2030” të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara;

bien dakort se është në interesin e përbashkët të AP dhe INSTAT (të referuara individualisht si “Palë” dhe bashkarisht si “Palët”) dhe në linjë me mandatet e tyre respektive referuar në ligjet kombëtare ne fuqi, të cilat rregullojnë aktivitetin e të dyja Institucioneve, specifikisht si më poshtë:

- Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” (në vijim referuar “Ligji i statistikave”);
- Ligji nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”;

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit si vijon:

Neni 1

Qëllimi

- 1) Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është i dyfishtë:
 - a) Krijimi i një programi bashkëpunimi midis palëve për të promovuar një kuptim më të gjërë të rëndësisë së zhvillimit dhe përdorimit të informacionit statistikor për të informuar, zbatuar dhe për të vlerësuar politikat kombëtare dhe programet të cilat mund të kenë ndikim mbi respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut;
 - b) Krijimin e një marrëdhënie ndërvepruese për të fuqizuar bashkëpunimin në mbledhjen e të dhënave, ndarjen, shpërndarjen dhe analizën për të ndihmuar në matjen e progresit dhe për të siguruar që asnjë mos të mbetet prapa në Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm të 2030, dhe për të qenë në përputhje me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;



- 2) Të gjitha aktivitetet e përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, do të zbatohen në përputhje me praktikat dhe rregullat respektive të palëve.

Neni 2

Objekti dhe përgjegjësitë e Palëve

- 1) Bashkëpunimi midis Palëve do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:
 - a) Identifikimin dhe përpilimin e indikatorëve përkatës kontekstualë dhe zhvillimin e metadave të lidhura, duke u mbështetur në udhëheqjen e treguesve të drejtave të njeriut dhe në një përjasje të bazuar në të drejtat e njeriut për të dhënat e zhvilluara nga Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara ('OHCHR'). Ky përpilim duhet të pranohet dhe të bihet dakord nga Palët brenda gjashtë muajve, që nga hyrja në fuqi e këtij Memorandumi Mirëkuptimi;
 - b) Mbledhjen, analizimin, shpërndarjen dhe publikimin e të dhënave, në lidhje me indikatorët e identifikuar, të ndara mbi bazën e diskriminimit të ndaluar nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, si të përshtatshme. Mbledhja e të dhënave, analizimi dhe ruajtja duhet të jetë përgjegjësia parësore e INSTAT-it, dhe duhet të kryhet në linjë me standardet e përshtatshme të drejtave të njeriut dhe statistikave zyrtare, duke përfshirë privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave;
 - c) Publikimin e raporteve dhe analizave të përbashkëta, sipas një plani të dakordësuar, të cilat prezantojnë të dhëna mbi të drejtat e njeriut. Këto raporte mund të përmbajnë të dhëna të lidhura me të drejta të zgjedhura ose çështje tematike të lidhura me të drejtat e njeriut ose mund të përshkruajnë punën e ndërmarrë për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave statistikore. Të dhënat e përfshira në raporte duhet të prezantohen objektivisht, pa komente mbi shpjegimet e mundshme për ndryshime, përtej ndryshimeve që kanë ardhur si pasojë e metodologjive të mbledhjes. Gjithsesi, çdo palë mund t'i referohet individualisht indikatorëve dhe të dhënave në publikime dhe materialeve të tjera, dhe mund të përdorë indikatorët dhe të dhënat për qëllime advokimi. Raporti i parë duhet të publikohet brenda një viti pas firmosjes së Memorandumi të Mirëkuptimit;
 - ç) Dhënie e këshillimit dhe asistencës për palën tjetër në fushën e ekspertizës së çdo pale.
- 2) Përgjegjësitë e INSTAT
 - a) INSTAT duhet në veçanti të këshillojë AP për metodologjitë e mbledhjes së të dhënave dhe parimet e statistikave zyrtare, duke përfshirë përzgjedhjen e kampionëve të përshtatshëm dhe parime të tjera të modelit të kërkimit ku AP planifikon të bëjë anketime;
 - b) INSTAT duhet në veçanti të këshillojë AP në kuptimin dhe përdorimin e duhur të statistikave zyrtare. Kjo do të përfshijë sigurimin e statistikave të disagreguara deri në nivelin që lejon legjislacioni për statistikave zyrtare, sipas mundësisë dhe informacionin e mundur në lidhje me metodologjinë dhe cilësinë e të dhënave;
 - c) INSTAT duhet të përfshijë AP në veprimtarinë e grupeve të këshillimit në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucioneve respektive, nën cilësinë e anëtarit të grupit apo vëzhguesit.



3) Përgjegjësitë e AP

- a) AP duhet veçanërisht të japë ndihmën e kërkuar këshilluese për respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut;
- b) AP në mënyrë të veçantë do të këshillojë INSTAT-in për grupet e popullsisë të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave dhe përfaqësimin e disagregimit në linjë me Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm të vitit 2030;
- c) AP në mënyrë të veçantë duhet të japë informacion kontekstual për të ndihmuar në interpretimin e të dhënave dhe përmirësimin e qasjeve për mbledhjen e të dhënave;
- d) AP në mënyrë të veçantë duhet të asistojë INSTAT-in në angazhimin e tyre me grupet e interesit për qëllimin e pjesëmarrjes në hartimin, hulumtimin dhe përmirësimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave.

4) Përgjegjësi të përbashkëta

- a) Puna bashkëpunuese drejt përmirësimit të mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave duke përdorur të dhënat ekzistuese të AP;
- b) Trajnime mbi të drejtat e njeriut dhe statistikat bazë që do të shkëmbehen për integrim në programet e punës të të dyja palëve.

Neni 3

Palët e treta

Palë të treta mund të angazhohen në punën e kryer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi me dakortësinë e të dyja Palëve, si për shëmbull agjenci të tjera qeveritare, organizata të shoqërisë civile, institucione akademike, etj. Marrëveshjet me palët e treta do të trajtohen në mënyrë të ndarë nga Memorandumi i Mirëkuptimit, me marrëveshje që do të arrihen mes palëve në lidhje me qeverisjen dhe rregullat për menaxhimin e projekteve.

Neni 4

Modalitetet e bashkëveprimit

Me qëllim që të sigurohet zbatimi i këtij Memorandumi, brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të tij krijohet një grup pune përgjegjës për të koordinuar aktivitetet e palëve.

Grupi i punës ngrihet me urdhër të përbashkët të palëve.

1) Grupi i Punës:

- a) Përbëhet nga 2 ose më shumë anëtarë me pjesëmarrjen e të paktën 1 anëtari të menaxhimit të lartë të zgjedhur me konsensusin e titullarëve të institucioneve, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë mes palëve;
- b) Kryesohet nga një përfaqësues i INSTAT-it, anëtar i Grupit të Punës;
- c) Mblidhet të paktën një herë në tre muaj ose kur kërkohet nga njëra palë;

2) Grupi i punës ka këto detyra:

- a) Përcakton shkaqet dhe pengesat që ndalojnë arritjen e plotë të rezultateve të pritshme;



- b) Paraqet propozime për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë edhe modifikimet e mundshme të Memorandumit, si dhe ia paraqet për miratim institucioneve, sipas të njëjtës procedurë që ndiqet për nënshkrimin e këtij memorandumi;
- c) Anëtarët e Grupit të punës raportojnë tek titullarët e institucioneve përkatëse mbi rezultatet e takimeve dhe rekomandimet për punën e mëtejshme.
- d) Anëtari i Grupit i menaxhimit të lartë është përgjegjës për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi në secilin Institucion dhe do të takohen të paktën 1 herë në vit për diskutim.

Neni 5

Statusi i Memorandumit të Mirëkuptimit

- 1) Për qëllime ligjore, asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet si krijim i një sipërmarrje të përbashkët, një marrëdhënie agjencie ose një partneriteti juridik midis Palëve. Marrëveshjet specifike për aktivitetet individuale përcaktohen në marrëveshje me shkrim që do të bien dakord më pas nga Palët. Zbatimi i këtij Memorandumi dhe të gjitha marrëveshjeve të lidhura do të mbetet subjekt i rregullave normale dhe procedurave të vendimmarrjes të secilës Palë.
- 2) Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet si cënim i pavarësisë ose i rolit kushtetues / ligjor të secilës Palë.
- 3) Asgjë në këtë Memorandum të Mirëkuptimit nuk mund ta fuqizojë secilën palë të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi Palën tjetër.

Neni 6

Burimet Financiare

- 1) Nga ky Memorandum Mirëkuptimi nuk do të lindin detyrime financiare nga një palë tek tjetra.
- 2) Secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta të punës në lidhje me zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, përveç rasteve të shërbimeve të konsulencës apo zbatimit të marrëveshjeve të tjera të dakordësuara ndërmjet Palëve.

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë nga Memorandumi apo në lidhje me të do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave mes INSTAT-it dhe AP, ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht.

Neni 8

Kohëzgjatja

- 1) Ky Memorandum lidhet për një afat fillestar prej tre vjetësh dhe është subjekt i ndryshimeve vetëm me konsensusin e të dyja palëve. Ky afat mund të zgjatet me dakortësi midis palëve.
- 2) Secila palë mund ta përfundojë Memorandumin duke lajmëruar me shkrim palën tjetër 3 muaj përpara përfundimit.



- 3) Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit sipas përcaktimeve të nenit 7. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.

Neni 9

Hyrja në fuqi

- 1) Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij nga përfaqësuesit e palëve.
- 2) Memorandumi hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta origjinale në gjuhën shqipe.


**PËR
AVOKATIN E POPULLIT**

**ERINDA BALLANCA
AVOKATI I POPULLIT**



**PËR
INSTITUTIN E STATIKSTIKAVE**

**ELSA DHULI
ZV/KRYETAR I BORDIT DREJTUES**



Tiranë 03 Shtator 2020